



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Legjislatura II
Nr.
Datë: 18.04.2007.
Prishtinë

PROCESVERBAL
I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja është mbajtur më 18.04.2007, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, salla N-225, në orën 13,00.

Nga shërbimi Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës, në mbledhje morën pjesë:

- Natasha Tishma – Prica, bashkëpunëtore profesionale e Komisionit;
- Ahtere Loxha, zyrtare ligjore;
- Arta Hajra, asistente ligjore;
- Monitorimi i OSBE-s;
- Qemajl Ahmeti, nga Zyra për të Drejtat e Njeriut;

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komisionit, z. Rangjel Nojkiq.

Pas konstatimit që në mbledhje nuk janë të pranishëm, anëtarët e Komisionit: Nuran Malta dhe Bislim Hoti, kryetari e hapi mbledhjen dhe e propozoi këtë:

R e n d i d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbaleve të datës 02.04.2007 dhe 11.04.2007.
3. Shqyrtimi i P/ligjit për kemikatet nr. 02-2812-L 116/1, më raport të Komisionit Funkcional- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente
4. Shqyrtimi i P/ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse nr. L 109, me raport të Komisionit Funkcional- Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, më amendamente
5. Përcaktimi i raportuesit për shqyrtim të P/ligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 2004/8 për energji, më raport të Komisionit Funkcional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, më amendamente
6. Përcaktimi i raportuesit për shqyrtim të P/ligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 2004/9 për rregullatorin e energjisë, me raport të Komisionit Funkcional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, më amendamente
7. Të ndryshme

1. Kryetari i Komisionit konstatoi qe rendi i ditës është miratuar, ai propozoi qe në pikën “**të ndryshme**” të shqyrtohen tri çështje:

7.1 T’i dërgohet një kërkesë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për dorëzimin e :

- **Raportit financiar për mjetet e harxhuara në vitin 2006.**
- **Buxhet planit për vitin 2007.**

7.2. Marrëveshje rreth organizimit të pritjes së delegacionit të komisionit homolog të Republikës së Maqedonisë

7.3. Konsultimet lidhur me vizitën në KK në Pejë

Propozimi i kryetarit për shqyrtim të çështjeve të cekura më lart, njëzëri është miratuar.

Kryetari i Komisionit e hapi shqyrtimin lidhur me pikën e dytë të renditë të ditës:

2. Miratimi i procesverbaleve të datës 02.04.2007 dhe 11.04.2007.

Kryetari i komisionit konstaton qe ky miratohet me vërejtjet e Numan Baliqit, Mahir Jagcillarit dhe të Sanije Alijaj, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën dhe stilin e të shkruarit, që do të thotë se nuk janë të shkruar në mënyrë të kuptueshme dhe duhet mënjeluar çdo dykuptimësi.

Pas paraqitjes së vërejtjeve dhe duke pasur parasysh që dokumentet zyrtare janë transparente dhe gjenden në web faqen e Kuvendit, komisioni nxori këtë:

P e r f u n d i m

Obligohet shërbimi i sekretariatit t ia dërgojë Shërbimit Gjuhësorë, përkatësisht lektorëve, kërkesën për lekturimin e procesverbaleve, në mënyrë që të mënjanoen mangësitë e natyrës gjuhësore dhe terminologjike.

Kryetari e hapi debatin lidhur me pikën e tretë të renditë të ditës:

3. Shqyrtimi i P/ligjit për kemikatet nr. 02-2812-L 116/1, me raport të Komisionit Funkcional-Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, më amendamente

Kryetari: Shqyrtimi i këtij P/ligji ka qenë pikë e renditë të ditës në mbledhjen e kaluar, dhe lidhur më këtë nuk kemi diskutuar, por e kemi caktuar z. Mahir Yagcilar, raportues për Ligjin për kemikatet. Kështu qe e ftoj z. Mahir Yagcilar, në cilësi të raportuesit, të na prezantojë ligjin më amendamente.

Mahir Yagcilar: Më vetë dëshirë kam pranuar qe komisionin ta informoj lidhur me Ligjin dhe me amendamentet e propozuara. Me vëmendje e kam lexuar ligjin dhe amendamentet e propozuara, dhe mund të them se nga aspekti i komuniteteve nuk kam vërejtur cenim të të drejtave dhe të interesave të komuniteteve, sepse i njëjti kryesisht e rregullon edhe materien e prodhimit të kemikatet dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut. Kjo është shumë e rëndësishme si për mjedisin jetësor, ashtu edhe për shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve. Do të kisha cekur qe ligji përmban një nen shumë të rëndësishëm, e ai është neni 19(b) me emërtimin “Etiketimi i substancave” i cili parasheh qe çdo njësi për paketim të materieve të rrezikshme harton udhëzimin për përdorim në të gjitha gjuhët zyrtare të harmonizuar me kushtet e përcaktuara me ligj. Nga aspekti i përdorimit të barabartë të gjuhëve është i kënaqshëm, si dhe nga aspekti i mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe informimit për rreziqe të ndryshme. Por, janë disa nene të cilat nuk përputhen njeri më tjetrin, dhe lidhur me këtë ia kam tërhequr vërejtjen Komisionit Funkcional, i cili sigurisht këto mangësi i ka mënjeluar.

Kështu që mund t'i rekomandoj Komisionit që Ligjin dhe amendamentet e propozuara t'i miratojë me konstatim që ky nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, më iniciativë për miratim të mëtutjeshëm në Kuvend.

Pas raportimit dhe duke marrë parasysh që diskutime të tjera nuk kishte, Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohet P/ligji për kemikatet me raport të Komisionit Funkcional me konstatim se ky nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandohet Kuvendit ta miratojë.

Kryetari hapi shqyrtimin lidhur me pikën e katër të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i P/ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse nr. L 109, me raport të Komisionit Funkcional- Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, më amendamente

Kryetari: Për raportimin lidhur më P/ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, është caktuar z. Numan Baliq, dhe e ftoj që ligjin së bashku me amendamente e propozuara të na prezantojë.

Numan Baliq: Dispozitat e P/ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i propozoj Komisionit që ta miratojë së bashku me amendamentet e propozuara.

Pas raportimit dhe duke pasur parasysh që diskutime të tjera nuk kishte, komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet P/ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse me raport të Komisionit Funkcional, më konstatim që i njëjti nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i procedohet Kuvendit për miratim.

Kryetari e hapi debatin për pikën e gjashtë të rendit të ditës dhe e nxori këtë përfundim:

5. Caktimi i raportuesit për shqyrtim të P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/8 për energji, me raport të komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, më amendamente.

6. Caktimi i raportuesit për shqyrtim të P/ligjit për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr. 2004/9 për rregullatorin e energjisë, me raport të Komisionit Funkcional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente.

P ë r f u n d i m

Për raportues të komisionit për pikat 5 dhe 6 caktohet kryetari i komisionit, Rangjel Nojkiç.

Kryetari e hapi debatin për pikën e shtatë të rendit të ditës

7. Të ndryshme

Xhevdet Neziraj: E përshëndes iniciativën e Komisionit lidhur me dërgimin e kërkesës MKK- së për prezantim të raportit financiar të hollësishëm për 2007, në bazë të te cilit do të mund të analizojmë se për çka komunitetet kanë nevojë, sepse projekti për buxhet të 2008 është në fazën e planifikimit dhe në këtë drejtim duhet të jetë shumë më pozitiv.

Gjithashtu, do të kisha përmendur çështjen lidhur me pakon e Ahtisarit i cili parasheh planin legjislativ, përkatësisht ligjet të cilat kanë të bëjnë me komunitete dhe në këtë drejtim gjatë hartimit të tyre duhet kërkuar ndihmën juridike. Duke marrë parasysh që kemi probleme të mëdha, Komisioni ka mundësi ta organizoj një dëgjim publik lidhur me ndonjë ligj që ka të bëjë me të gjitha komunitetet.

Pas diskutimit të deputetit Xhevdet Neziraj dhe sugjerimeve të kryetarit, të nënkryetarit të Komisionit, si dhe votimit, Komisioni nxori këto

P Ë R F U N D I M E

Për pikën 7.1. Komisioni nxori këtë

1. Përfundim

7.2 T'i dërgohet një kërkesë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim që të dorëzojë :

- **Raportin financiar për mjete e harxhuara në vitin 2006.**
- **Buxhet planin për vitin 2007.**

Për pikën 7.2. Komisioni nxori këtë:

2. Pë r f u n d i m

Ti dërgohet një shkresë Komisionit për Komunitete dhe Kthim, kryetarit të Kuvendit të Kosovës z. Kolë Berisha lidhur me ë pritjen e Delegacionit të Komisionit homolog të Republikës së Maqedonisë me kërkesë për lejimin, mbështetjen dhe caktimin e terminit të pritjes.

Për pikën 7.3. Komisioni nxori këtë:

3. Pë r f u n d i m

Për aranzhimin e vizitës së në KK Pejë obligohet z. Numan Baliq dhe në periudhë kohore prej dy ditëve ta informojë Sekretariatit për kohën e vizitës, në mënyrë që të ndërmerren të gjitha përgatitjet e nevojshme për realizimin e vizitës.

Mbledhja përfundoi në 13,40.

Shërbimi i Sekretariatit:

Procesverbalin e hartoi: Natasha Prica-Tishma

Kryetari i Komisionit
Rangjell Nojkiç